



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 1453, datë 02.12. 2010

“Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave në brezin 1920-1935 MHz çiftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spektër i paçiftuar për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, për të ofruar shërbime të lëvizshme tokësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në mbledhjen e datës 02.12.2010, sipas rendit të ditës dhe procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë” mori në shqyrtim çështjen e mëposhtme:

Pajisjen e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a me autorizim individual, për përdorimin e frekuencave në brezat (1920-1935) MHz çiftuar me (2110-2125) MHz dhe (1900-1905) MHz, spektër i paçiftuar, për ndërtimin e rrjetit dhe ofrimin e shërbimeve të lëvizshme tokësore me brez të gjerë, në zbatim të VKM Nr.1252, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, dhe VKM Nr.501 datë 9.6.2010, “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.1252, datë 10.9.2010, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”.

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 66-78 dhe 80-86 të Ligjit 9918 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë”;
2. Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr.1252, datë 10.9.2008 dhe Nr.501, datë 9.06.2010.
3. Rregullore për Autorizimin Individual, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 510 dt. 04.11.2008.
4. Raporti Përmbledhës të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, nr.2839/15, datë 17.11.2010, në të cilin Vodafone Albania sh.a. renditej i pari nga ofruesit, pra fitues i tenderit të hapur.

5. Rregullore e Brendshme, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë” mori në shqyrtim çështjen e mëposhtme:

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar:

V Ë R E N

1. Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin Nr. 1448, datë 18.11.2010, në përfundim të tenderit publik me procedurë të hapur, *me objekt*, **“Dhënia e 1 (një) të drejte përdorimi në brezin e frekuencave 1920-1935 MHz çiftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spektër i paçiftuar që ofrojnë shërbime me brez të gjërë”**, miratoi:
 - a) Raportin Përmbledhës të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, nr.2839/15, datë17.11.2010, në të cilin Vodafone Albania sh.a. renditej i pari nga oferuesit, pra fitues i tenderit të hapur.
 - b) Njoftimin e Fituesit, sipas Shtojca 16- Formulari i Njoftimit të Fituesit.
2. AKEP, bashkëlidhur shkresës Nr.2839/18 Prot., datë 18.11.2010 i ka dërguar Vodafone Albania sh.a., Formularin e Njoftimit të Fituesit, Nr.2839/19 Prot., datë 18.11.2010, sipas Shtojca 16, të përfshirë në dokumentacionin e tenderit.
3. Vodafone Albania Sh.a., me shkresën Nr.3404 prot., datë 25.11.2010, brenda afatit 7 (shtatë) ditë, nga data marrjes se Formularit të njoftimit të fituesit, njoftoi kryerjen e pagesave, të mëposhtme:
 - a) Çmimin e ofertës me shumën 31.400.000 (tridhjetënjëmilionë katërqindmije) Euro, më datë 25.11.2010, në Logarine bankare me emërtim: Depozita e Qeverisë.
 - b) Pagesën për përdorimin e frekuencave të brezit (1920.3-1935.3/2110.3-2125.3) MHz dhe (1900.0-1905.0) MHz, në shumën 583.333 (pesëqindetëtetremijëetreqindëe tridhjetëtre) lekë, për vitin 2010, më datën 25.11.2010
 - c) Tarifën e shërbimit për shërbimet e radiokomunikimit, për brezat e frekuencave (1920.3-1935.3/2110.3-2125.3) MHz dhe (1900.0-1905.0) MHz, në shumën 1.852.200 (njëmilionetëqindëepesëdhjetëedymijëedyqindë) lekë, për vitin 2010, më datën 25.11.2010.

Pagesat sipas pika b) dhe c) të mësipërme, janë kryer në llogarinë bankare të AKEP me Nr: AL89101100800000002111001E.

Përfundimisht

Bazuar në sa më sipër, në kompetencat që i janë dhënë nga Ligji Nr. 9918 date 19.05.2008 dhe Ligji Nr. 10 118 date 23.04.2009, Këshilli Drejtues i AKEP

VENDOSI:

1. Te pajise sipërmarrësin “Vodafone Albania” sh.a me Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave te brezit (1920.3-1935.3/2110.3-2125.3) MHz dhe (1900.0-1905.0) MHz siç përshkruhet në Aneksin 1 bashkëlidhur Autorizimit Individual.
2. Sipërmarrësi duhet të fillojë të ofrojë për publikun, shërbime të lëvizshme me brez të gjerë nëpërmjet rrjetit të vet, brenda 2 (dy) muajve, nga data e marrjes se këtij Autorizimi Individual.
3. Sipërmarrësi të ofrojë shërbimet e cilësuara, siç përshkruhet ne Aneksin 4 bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ne datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

A U T O R I Z I M I N D I V I D U A L

Nr.1453, datë 02.12.2010

PËR
“PËRDORIMIN E FREKUENCAVE”

1920-1935 MHz çiftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz
spektër i paçiftuar

Sipërmarrësit: “VODAFONE ALBANIA ” sh.a

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANEKS NR. 1 :

KUSHTET/KRITERET PËR SHFRYTËZIMIN DHE PËRDORIMIN E FREKUENCAVE

1. Autorizimi Individual i miratuar me Vendimin Nr.1453, datë 02.12.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP i jep sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a të drejtën e përdorimit të frekuencave **(1920-1935) MHz çiftuar me (2110-2125) MHz dhe (1900-1905) MHz** me qëllim ndërtimin e rrjetit për te ofruar *shërbim publik të lëvizshëm tokësor me brez të gjerë*, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a, në mbështetje të Autorizimit Individual, është i detyruar të ndërtojë dhe të fillojë *shërbimin publik të lëvizshëm tokësor me brez të gjerë*, brenda një periudhe 2-mujore nga data e marrjes së Autorizimit Individual, duke respektuar të gjithë kuadrin ligjor dhe rregullator të fushës.
3. Autorizimi Individual është specifik për të autorizuarin. Ai nuk mund të shitet, jepet me qera, të transferohet apo të jepet si garanci, pa miratimin paraprak të AKEP. Asnjë ndryshim i kontrollit të të Autorizuarit, qoftë i drejtpërdrejtë apo i tërthortë nuk mund të bëhet pa lejen paraprake, me shkrim, të AKEP.
4. Sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a., për ndërtimin e rrjetit dhe përdorimin e frekuencave radio të marra në përdorim: **(1920-1935) MHz çiftuar me (2110-2125) MHz dhe (1900-1905) MHz**, të zbatojë rekomandimet dhe standardet e ITU, CEPT dhe ETSI.
5. Sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a me marrjen e Autorizimit Individual është i detyruar të zbatojë:
 - a) Planin për shtrirjen dhe konfigurimin e rrjetit, që do ndërtohet për mbulimin me shërbim, sipas deklaramit të dhënë në Ofertë, Shtojca 5, përfshirë në Aneks 3 të këtij Autorizimi Individual.
 - b) Ofrimin e shërbimeve të deklaruara në Ofertë, Shtojca 6, të përfshirë në Aneks 4, të këtij Autorizimi Individual.
6. Sipërmarrësi është i detyruar që brenda 60 ditëve kalendarike nga data e marrjes së Autorizimit Individual të paraqesë pranë AKEP një projekt të detajuar për realizimin e Planit për shtrirjen dhe ndërtimin e rrjetit, mënyren e realizimit të lidhjeve ndërmjet stacioneve baze si dhe vendndodhjen e tyre. Ky projekt të jetë me afate të përcaktuara, të ndara për cdo 6-mujor të periudhës 18 mujore. Sipërmarrësi është i detyruar të raportojë pranë AKEP lidhur me përqindjen e territorit që mbulohet me shërbim prej rrjetit të ndërtuar prej tij sipas grafikut 18 mujor.
7. Afati i vlefshmërisë së përdorimit të frekuencave, (1920-1935) MHz çiftuar me (2110-2125) MHz dhe (1900-1905) MHz, është deri në datën 31.12.2025.
8. Rinovimi i autorizimit individual do të bëhet në fund të përfundimit të periudhës së vlefshmërisë, në përputhje me përcaktimet e Ligjit 9918 datë 19.05.2008 apo legjislacionit në fuqi në kohën përkatëse.
9. Nëse operatori nuk përmbush të paktën një prej detyrimeve të mësipërme, AKEP ndërmerr masat në përputhje me nenin 135 dhe në vijim të Ligjit 9918 datë 19.05.2008.

ANEKS NR. 2 :

Operator	Frekuencat [MHz]		Afati vlefshmërisë
	Up Link	Down Link	
Vodafone Albania sh.a	1900.0– 1905.0		Dhjetor 2010 – Dhjetor 2025
	1920.3-1935.3	2110,3-2125,3	Dhjetor 2010 – Dhjetor 2025

Përcaktimi i frekuencave bartëse, për gjerësi kanali 5 MHz, në brezat e mësipërm të frekuencave përcaktohet sipas Specifikimeve teknike të 3GPP (3rd Generation Partnership Project) dhënë në 3GPP TS 25.104. V9.5.0 (2010-09).

Frekuencat bartëse përcaktohen sipas UARFCN (UTRA Absolute Radio Frequency Channel Number). Për çdo brez, UARFCN, përcaktohet sipas formulave:

Për Up link : $N_{up} = 5 * (F_{ul} - F_{ul_Offset})$; dhe

Për Down Link: $N_{down} = 5 * (F_{down} - F_{dl_Offset})$

Ndarja e kanaleve me gjëresi 200 KHz Brezi (1920.3-1935.3/2110.3-2125.3) MHz.

Nr	f Up Link	f D/ Link	Tx-Rx	Nr	f Up Link	f D/Link	Tx- Rx	Nr	f Up Link	f D/Link	Tx-Rx
1	1920.4	2110.4	190	26	1925.4	2115.4	190	51	1930.4	2120.4	190
2	1920.6	2110.6	190	27	1925.6	2115.6	190	52	1930.6	2120.6	190
3	1920.8	2110.8	190	28	1925.8	2115.8	190	53	1930.8	2120.8	190
4	1921	2111	190	29	1926	2116	190	54	1931	2121	190
5	1921.2	2111.2	190	30	1926.2	2116.2	190	55	1931.2	2121.2	190
6	1921.4	2111.4	190	31	1926.4	2116.4	190	56	1931.4	2121.4	190
7	1921.6	2111.6	190	32	1926.6	2116.6	190	57	1931.6	2121.6	190
8	1921.8	2111.8	190	33	1926.8	2116.8	190	58	1931.8	2121.8	190
9	1922	2112	190	34	1927	2117	190	59	1932	2122	190
10	1922.2	2112.2	190	35	1927.2	2117.2	190	60	1932.2	2122.2	190
11	1922.4	2112.4	190	36	1927.4	2117.4	190	61	1932.4	2122.4	190
12	1922.6	2112.6	190	37	1927.6	2117.6	190	62	1932.6	2122.6	190
13	1922.8	2112.8	190	38	1927.8	2117.8	190	63	1932.8	2122.8	190
14	1923	2113	190	39	1928	2118	190	64	1933	2123	190
15	1923.2	2113.2	190	40	1928.2	2118.2	190	65	1933.2	2123.2	190
16	1923.4	2113.4	190	41	1928.4	2118.4	190	66	1933.4	2123.4	190
17	1923.6	2113.6	190	42	1928.6	2118.6	190	67	1933.6	2123.6	190
18	1923.8	2113.8	190	43	1928.8	2118.8	190	68	1933.8	2123.8	190
19	1924	2114	190	44	1929	2119	190	69	1934	2124	190
20	1924.2	2114.2	190	45	1929.2	2119.2	190	70	1934.2	2124.2	190
21	1924.4	2114.4	190	46	1929.4	2119.4	190	71	1934.4	2124.4	190
22	1924.6	2114.6	190	47	1929.6	2119.6	190	72	1934.6	2124.6	190
23	1924.8	2114.8	190	48	1929.8	2119.8	190	73	1934.8	2124.8	190
24	1925	2115	190	49	1930	2120	190	74	1935	2125	190
25	1925.2	2115.2	190	50	1930.2	2120.2	190	75	1935.2	2125.2	190

Brezi	TDD			
	1900-1905 MHz			
Nr	f uplink/down link		f uplink/down link	
1	1900	14	1902.6	
2	1900.2	15	1902.8	
3	1900.4	16	1903	
4	1900.6	17	1903.2	
5	1900.8	18	1903.4	
6	1901	19	1903.6	
7	1901.2	20	1903.8	
8	1901.4	21	1904	
9	1901.6	22	1904.2	
10	1901.8	23	1904.4	
11	1902	24	1904.6	
12	1902.2	25	1904.8	
13	1902.4			

Tabela e mëposhtme jep numrin e kanalit sipas UARFCN për “downlink” dhe “uplink” referuar ndarjes për gjërësi kanali (Channel spacing) 5 MHz

Brezi 2.1 GHz (3GPP Band I)	UARFCN DL	UARFCN UL	Frekuenca e qendrës DL në MHz	Frekuenca e qendrës UL në MHz
Kanali i pare 5 MHz	10564	9614	2112.8	1922.8
Kanali i dyte 5 MHz	10589	9639	2117.8	1927.8
Kanali i tretë 5 MHz	10614	9664	2122.8	1932.8

Sipërmarrësi në përcaktimin e frekuencave bartëse në brezat e mësipërm, duhet të zbatojë kërkesat e ECC/DEC/ (06) 01, Annex 1, Harmonised Spectrum Scheme for IMT-2000/UMTS, të cilat janë:

1. Ndarja e kanaleve realizohet me gjerësi 200 kHz.
2. Frekuencat bartëse (carrier frequency) përcaktohen si shumëfishe të gjerësisë së kanalit 200 kHz.
3. Frekuencat bartëse të dy operatorëve, të ndryshëm, në sistemin FDD, duhet të jenë në distancë minimale 5 MHz. Secili operator, bazuar në ndarjen 200 kHz të kanaleve, frekuencën bartëse FDD mund ta përcaktojë më të vogël se 5 MHz.
4. Në brezin e frekuencave (1900-1920) MHz, frekuenca bartëse TDD, të brezave të operatorëve të ndryshëm duhet të jetë jo më e vogël se 5 MHz. Frekuenca bartëse TDD, në brezat përkatës të operatorëve mund të përcaktohet, bazuar në ndarjen e kanaleve me gjerësi 200 kHz, më të vogël se 5 MHz.

5. Frekuenca bartëse, më e afërt me frekuencën 1900 MHz (TDD) duhet të jëtë më e madhe ose e barabartë me $F_c=1902.4$ MHz ($F_c \geq 1902.4$ MHz)
6. Frekuenca bartëse, më e afërt me frekuencën 2110 MHz (FDD) duhet të jëtë më e madhe ose e barabartë me $F_c=2112.8$ MHz ($F_c \geq 2112.8$ MHz)

ANEKS NR.3:

**“PLANI PER SHTRIRJEN DHE KONFIGURIMIN E RRJETIT
PER MBULIMIN ME SHERBIM”**

Sipërmarrësi do të ndërtojë dhe konfigurojë rrjetin për të realizuar shtrirjen gjeografike të mbulimit me shërbim, sipas afatit dhe përcaktimeve të tabelës së mëposhtme :

TABELA NR. 3 : Për 18 (tetëmbëdhjetë) muajt e parë pas marrjes së Autorizimit Individual:

Periudha nga koha e marrjes së Autorizimit Individual	Shtrirja gjeografike e rrjetit për mbulim me shërbim
Deri në fund të 6-mujorit të parë	36 % e territorit
Deri në fund të vitit të parë	65.5 % e territorit
Deri në fund të 18 muajve.	85 .6 % e territorit

ANEKSI NR. 4:

SHËRBIMET QË DO TË OFROHEN

Sipërmarrësi do të ofrojë për publikun shërbimet e mëposhtme :

Nr.	Shërbimet	Shënime
Shërbime të lidhjes		
1.	Akses interneti nëpërmjet telefonit celular dhe kompjuterit (PC).(<i>Internet access through mobile and PC</i>)	Web Browsing- Përmirësimi i cilësisë aktuale në terma të shpejtësisë dhe ofertave
2.	Video telefoni (Video telephony)	Thirrje video/ video konferencë me imazh dhe transmetim të dhënash.
3.	Aksesim i Internetit nga portali ose jashtë tij, plus aplikimet e ndryshme për celular smartphones (<i>Portal Browsing on and of + applications</i>)	Web Browsing - Nëpërmjet kanaleve të ndryshëm aksesit (opsione të ndryshme browsing dhe aplikacione mobile)
4	Bisede telefonike mbi protokoll interneti (<i>Voice over IP</i>)	Biseda telefonike në lidhje transmetim të dhënash
Shërbime të lëvizshme		
5	<i>Mobile office</i>	Mjetet edhe përdorimet e ndryshme që lehtësojnë klientet e biznesit të lidhen me zyrën e tyre ndërsa janë në lëvizje
6	Shërbimet on-line (<i>On-line services</i>)	Vetshërbimet on-line/ shopping on-line interaktiv
7	<i>Machine to machine services</i>	Menaxhimi nga largësia për shërbimet e ndryshme utilitare.
Shërbime me përmbajtje		
8	Ndërfaqja që mundëson aksesin në shërbime të ndryshme me përmbajtje (<i>Mobile Portal</i>)	Shërbim i lidhur me përmbajtjen, që do të përfshijë kategori të tilla si: Informacion/argëtim-lajme, bursa, sporte, lojra , video muzikore, përmbajtje për të rritur, chat; Video humoristike, kartolina, pamje, tekst, mesazhe multimedial dhe foto, aplikacione personalizimi si ringtone (zile), screensaver, etj.
9	Televizioni në celular (<i>Mobile TV</i>)	Kanale TV të ofruara në një ndërfaqe lehtësisht i përdorshëm nga ana e përdoruesve, të aksesueshme nga telefoni celular dhe kompjuteri personal (PC).
10	Video sipas kërkesës, transmetim video (<i>Video on Demand, Video streaming</i>)	Përmbajtje video e formatuar dhe e aksesueshme për përdorim mobil. Transmetim video dhe shkarkim (download) nëpërmjet celularit dhe PC.